



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:216851

Datë: 24.01.2025

Numri i dokumentit: 06754018

KPPP.nr.1167/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përbarimore të kreditorit N.P “Termokos” SH.A., me NUI: 810514829, me seli në Prishtinë, rruga “28 Nëntori”, nr. 181, Lagjja Dardania, kundër debitorit “Cataleya” SH.P.K., me seli në Prishtinë, rruga “Enver Maloku” nr.7, përfaqësuar sipas autorizimit nga Gazmend Halilaj, avokat në Gillogoc, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.209/2024 të datës 17.07.2024 të Përbaruesit Privat Arben Gashi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 24.01.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Cataleya” SH.P.K., ANULOHET urdhri përbarimor P.nr.209/2024 i datës 17.07.2024, i Përbaruesit Privat Arben Gashi dhe PËRFUNDOHET në tërësi përbarimi në këtë çështje përbarimore.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit N.P “Termokos” SH.A., ka caktuar urdhrin përbarimor P.nr.209/2024 të datës 17.07.2024, me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Kartelës Nr. 62001 të datës 12.07.2024 të lëshuar nga kreditori, me të cilin është detyruar debitori që në emër të përmbushjes së obligimeve të papaguara nga kartela e kontabilitetit të lartcekur, brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin t’ia paguajë kreditorit shumën prej 2,251.23 €, me kamatëvonesë prej 8% në vit, duke e llogaritur nga data kur kredia është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të propozimi, ashtu që përbarimi të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit,

nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogarinë e tij bankare, përmbarimi të zbatohet përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes të autorizuarës së tij, ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar se kërkesa e kreditorit është e parashkruar pasi që ka kaluar afati kur i njëjti ka mundur të kërkoj përmbushjen e borxhit bazuar në nenin 360 të LMD-së. Tutje ka shtuar se kreditori ka kërkuar përmbushjen e borxhit nga dy debitor, për më tepër kreditori e ka ngarkuar me borxh debitorin për lokalin me hapësirë prej 202.54 m², ndërsa lokali i debitorit sipas kontratës mbi qiranë me pronarin e lokalit ka një sipërfaqe prej 144.24 m², për më tepër kreditori nuk i ka kryer shërbimet ndaj debitorit, i njëjti ka parashtruar ankesa pranë kreditorit por nuk ka marr asnjëherë përgjigje nga i njëjti. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të refuzohet.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet dhe procedura përmbarimore të përfundohet në tërësi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm - Kartelës Nr. 62001 e datës 12.07.2024, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa në par.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen *“ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, kurse me nenin 37 të LPP-së,

përcaktohet se “Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - Kartela Nr. 62001 e datës 12.07.2024, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbardim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se një dokument i tillë, bazuar në dispozitën e nenit 29 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të LPP-së, nuk është i përcaktuar si dokument i besueshëm.

Bazuar në dispozitën e lartcekur është përcaktuar se në kuadër të dokumenteve të besueshme janë ekstraktet e verifikuara nga librat afariste vetëm sa i përket pagesave të shërbimeve komunale për furnizim me ujë, energji elektrike dhe bartje të mbeturinave. Andaj duke marr parasysh faktin se në rastin konkret propozimi për përmbardim është lejuar sipas një dokumenti - Kartelës Nr. 62001 të datës 12.07.2024 në kuadër të Ndërmarrjes Publike Termokos, gjykata vlerëson se dokumenti mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbardim, e mbi bazën e të cilit përmbarduesi privat ka lejuar përmbardimin, nuk konsiderohet dokument i besueshëm dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbarduesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohej në tërësi.

Meqenëse dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbardimor, përkatësisht kartela e kontabilitetit numër 60267-B, nuk është dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbardueshmërisë, gjykata nuk i shqyrtoi fare pretendimet e tjera të debitorit dhe kreditorit dhe duke u bazuar në nenin 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbardimore, si dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1167/24 datë 24.01.2025

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.